

20261963171

МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА И ТРУД

Në bazë të nenit 17-v paragrafi (2) të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 92/07, 136/11, 23/13, 25/13, 137/13, 164/13, 158/14, 15/15, 129/15, 192/15 dhe 30/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 18/20 dhe 74/25), ministri i Ekonomisë dhe Punës solli

PROGRAM PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR SIGURI GJATË PUNËS

Neni 1

Me këtë program përcaktohen materiali, rregulloret dhe literatura për dhënien e provimit profesional për siguri gjatë punës.

Neni 2

Programi për dhënien e provimit profesional për siguri gjatë punës përbëhet nga temat e mëposhtme:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
 - 1.1. Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit
 - 1.2. Organizimi i pushtetit shtetëror
 - 1.3. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut
 - 1.4. Vetëqeverisja lokale
 - 1.5. Marrëdhëniet ndërkombëtare
 - 1.6. Mbrojtja e Republikës, gjendja ushtarake dhe gjendja e jashtëzakonshme.
2. Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës
 - 2.1. Obligimet e përgjithshme të punëdhënësit;
 - 2.2. Obligime të tjera të punëdhënësit;
 - 2.3. Të drejtat dhe obligimet e punëmarrësve;
 - 2.4. Këshilli për siguri dhe shëndet gjatë punës;
 - 2.5. Autorizimi;
 - 2.6. Mbikëqyrja;
 - 2.7. Dispozitat kundërvajtëse.
3. Ligji për marrëdhëniet e punës
 - 3.1. Kreu XII – mbrojtja e veçantë e punëtorëve që nuk kanë mbushur ende 18 vjet të moshës.
 - 3.2. Kreu XIV – mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara dhe kapitujt;
 - 3.3. Kreu XV – mbrojtja e veçantë e punëtorëve më të moshuar.
4. Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor
 - 4.1. invaliditeti;
 - 4.2. puna që kryen i punësuari;
 - 4.3. punë tjetër e përshtatshme;
 - 4.4. aftësia e zvogëluar për punë;
 - 4.5. aftësia e mbetur për punë;
 - 4.6. humbja e aftësisë për punë;
 - 4.7. lëndim në punë;
 - 4.8. sëmundje profesionale;

- 4.9. të drejtat në bazë të aftësisë së mbetur për punë;
- 4.10. orar i shkurtuar i punës, sistemimi në vend tjetër të përshtatshëm pune;
- 4.11. kualifikim ose rikualifikim.
5. Ligji për sigurimin shëndetësor
- 5.1. sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.
- 5.2. të siguruarit;
- 5.3. e drejta për shërbime shëndetësore;
- 5.4. të drejtat për kompensime financiare;
- 5.5. sigurimi i mjeteve.
6. Ligji për mbrojtjen shëndetësore
- 6.1. të drejtat nga mbrojtja shëndetësore;
- 6.2. zbatimi i sigurimit shëndetësor;
- 6.3. sigurimi i mjeteve, kompensimi i dëmit për organizatat shëndetësore.
7. Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës
- 7.1. Konventa nr. 155 për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës;
- 7.2. Konventa nr. 161 për shërbimet e mjekësisë së punës;
- 7.3. Konventa nr. 81 për inspektimin e punës në industri dhe tregti.
8. Programi kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian
- 8.1. politika sociale dhe punësimi.
9. Strategjia e Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë
10. Masat për mbrojtje gjatë punës me ekrane
11. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve gjatë përdorimit të pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës
12. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë përdorimit të pajisjeve të punës nga punëtorët në vendin e punës
13. Shenjat për siguri dhe shëndet gjatë punës, pamja, ngjyra, madhësia
14. Mënyra e mbajtjes së evidencës në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës
15. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë bartjes manuale të ngarkesave, e cila paraqet rrezik për lëndime
16. Kërkesat minimale për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e tyre, që lindin nga ekspozimi ndaj zhurmës
17. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës në kantieret e përkohshme mobile të ndërtimit
18. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve në hapësirën e punës
19. Kushtet që duhet t'i përmbushë personi juridik ose fizik për kryerjen e punëve profesionale
20. Kërkesat minimale për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e tyre, që lindin nga ekspozimi ndaj vibrimeve mekanike
21. Mënyra e hartimit të deklaratës së sigurisë, përmbajtja e saj, si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut
22. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj asbestit gjatë punës
23. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë
24. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj substancave kancerogjene, mutagjene ose toksike për sistemin riprodhues
25. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj substancave kimike

26. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve të rinj
27. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve shtatzëna, punëtorëve që kanë lindur së fundmi ose që ushqejnë me gjë
28. Mënyra e zhvillimit të edukimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës për zhvillimin e edukimit
29. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve në industrinë e nxjerrjes së mineraleve me shpim
30. Mënyra e pikëzimit dhe pjesëmarrja aktive dhe pasive në trajnimet për avancim profesional të personave profesionalë për siguri gjatë punës
31. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve fizikë (rrezatim optik artificial)
32. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve në miniera me eksploatim sipërfaqësor dhe nëntokësor të lëndëve të para minerale
33. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve në anijet e peshkimit
34. Kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve të ekspozuar ndaj agjentëve fizikë – fushave elektromagnetike.

Neni 4

Rregulloret dhe literatura për dhënien e provimit profesional për siguri gjatë punës, të cilat janë dhënë në Shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e këtij programi.

Neni 5

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij programi, pushon të vlefshmi Programi për dhënien e provimit profesional për siguri gjatë punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/25).

Neni 6

Ky program hyn në fuqi ditën pas publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.12-4010/3
19.8.2026
Shkup

Ministri
Ekonomisë dhe Punës,
Besar Durmishi, d.v.

Rregulloret dhe literatura për dhënien e provimit profesional për siguri gjatë punës:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës,
- Ligji për marrëdhëniet e punës,
- Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor,
- Ligji për sigurimin shëndetësor,
- Ligji për mbrojtjen shëndetësore,
- Ligji për inspektimin e punës,
- Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore,
- Kodi Penal, nenet 166, 167, 168, 169, 170, 171 dhe 289.
- Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës
- Konventa nr. 155 për siguri dhe shëndet gjatë punës,
- Konventa nr. 161 për shërbimet e mjekësisë së punës,
- Konventa nr. 81 për inspektimin e punës në industri dhe tregti,
- Programi kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (politika sociale dhe punësimi),
- Strategjia e BE-së në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës,
- Rregullorja për masat e mbrojtjes gjatë punës me ekrane,
- Rregullorja për pajisjet personale mbrojtëse që punëtorët i përdorin gjatë punës,
- Rregullorja për siguri dhe shëndet gjatë punës gjatë përdorimit të pajisjeve të punës,
- Rregullorja për shenjat e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës,
- Rregullorja për mënyrën e mbajtjes së evidencës në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës,
- Rregullorja për siguri dhe shëndet gjatë punës gjatë bartjes manuale të ngarkesave,
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit për njoftim për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë,
- Rregullorja për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve të ekspozuar ndaj rrezikut nga zhurma,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës në kantieret e përkohshme dhe mobile të ndërtimit,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve në hapësirën e punës,
- Rregullorja për kushtet për punonjësit, organizimin, kushtet teknike dhe kushtet e tjera që duhet t'i përmbushë personi juridik ose fizik për kryerjen e punëve profesionale,
- Rregullorja për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve të ekspozuar ndaj rrezikut nga vibrimet mekanike,
- Rregullorja për mënyrën e hartimit të deklaratës së sigurisë, përmbajtjen e saj, si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve që janë potencialisht të ekspozuar ndaj rrezikut nga atmosferat shpërthyes,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet të punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj asbestit gjatë punës,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë.
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj substancave kancerogjene, mutagjene ose substancave toksike për sistemin riprodhues*,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj substancave kimike,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve të rinj,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve shtatzëna, punëtorëve që kanë lindur së fundmi ose që ushqejnë me gji*,
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, mënyrën e zhvillimit të edukimit dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për zhvillimin e edukimit.
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve në industrinë e nxjerrjes së mineraleve me shpim*,
- Rregullorja për mënyrën e pikëzimit dhe pjesëmarrjen aktive dhe pasive në trajnimet për avancim profesional të personave profesionalë për siguri gjatë punës, si dhe forma dhe formulari i vërtetimit për pikët e fituara për pjesëmarrje në trajnimet për avancim profesional,
- Rregullorja për lartësinë e shpenzimeve për lëshimin e lejes për kryerjen e punëve profesionale dhe dhënien e provimit profesional për siguri gjatë punës,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve fizikë,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve në miniera me eksploatim sipërfaqësor dhe nëntokësor të lëndëve të para minerale*.
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve në anijet e peshkimit*,
- Rregullorja për lartësinë e shpenzimeve për kryerjen e punëve profesionale për siguri gjatë punës,
- Rregullorja për kërkesat minimale për siguri dhe shëndet gjatë punës së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve fizikë (fushat elektromagnetike)*.